

Strategji për përfshirjen e prindërve në shkollë

- Së bashku me mësuesit, organizohen takime në ditë të veçanta. Prindërit ftohen në shkollë, me qëllim tregimin e punëve të fëmijëve, zhvillimin e bisedave joformale me stafin akademik apo angazhimin në orë mësimore me tematika kujdesin ndaj nxënësve.
- Prindërit nxiten që të ndajnë mendimet dhe idetë e tyre se çfarë është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë dhe cilat janë mënyrat më efektive për edukimin e tyre.
- Krijimi i nje kalendari me takime të përjavshme mësues-prindër. Takimet mund të fokusohen tek ecuria akademike, sjellja, mirëqenia, shëndeti dhe ngritja e strategjive të tjera të përshtatshme dhe pozitive për fëmijët.
- Pajisja e prindërve me materiale ndërgjegjësimi dhe informimi për praktikat pozitive të prindërimit, raporte për mënyrën e ushqyerjes apo kujdesit për shëndetin fizik dhe mendor.
- Krijimi i programeve të trajnimit prindëror, me qëllim njohjen e prindërve me praktika më efektive dhe jondëshkuese për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.
- Zhvillimi i partneriteteve me mekanizma që janë përgjegjëse për mirëqenien sociale, me qëllim referimin e fëmijëve që përjetojnë rrethana veçanërisht të vështira familjare.

